

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN XARRË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **komunën e Xarrë, Sarandë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më 30.06.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 114, datë 10.09.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 864/7, datë 10.09.2015, i ka rekomanduar z. Dhimitër Kote, Kryetar i komunës Livadhja, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetja nga auditimi: Në dokumentacionin e pronës është konstatuar se Aktet e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP), janë firmosur vetëm nga Kryetari i komisionit dhe jo dy anëtarët e tjerë të komisionit të tokës në fshat.

-Ka ndryshim midis numrit të AMTP-së të paraqitur në Printimin III dhe numrit AMTP –ve në realitet.

- Nga auditimi konstatohet se për pronat (toka) e privatizuara, procesverbali i dorëzimit të pronësisë, datë 26.8.1998 është formuluar vetëm 5 ditë pas vendimit nr.14/1, datë 21.08.1998 të Komisionit të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave.

Sipas procesverbalit të dorëzimit të pronësisë sipërfaqja e kullotës të kaluar në pronësi të z. H.B është 115.85 ha dhe jo 164 ha, pra është më pak 48,15 ha tokë.

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Konispol (në të cilën përfshihet Komuna Xarrë nga shkrirja e NJQV), në bashkëpunim me Këshillin e Qarkut Vlorë, Agjencinë e Kthimit të Pronave, të ndjekin me përparësi pronësinë, mbi parcelën nr.26 në fshatin Mursi, mbi liqenin e Mursisë, duke kryer procedurat e nevojshme teknike dhe ligjore për regjistrimin e këtyre pronave në ZVRPP Sarandë në pronësi të bashkisë, konform nenit 8 të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, i ndryshuar

Brenda muajit Tetor 2015

2. Gjetje nga auditimi: Struktura organizative, e miratuar me Vendim të Këshillit të Komunës në disa raste bien në kundërshtim me kërkesat e pikës 12, paragrafi i V, si dhe me lidhjen nr. 2 e 7, të VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të njësive të qeverisjes vendore”, i ndryshuar me VKM nr. 518, datë 16.08.2012 dhe VKM nr. 586, datë 17.07.2013, sepse në detyrën e Sekretarit të Këshilli të Komunës, Administratorit të Ndhmës Ekonomike, Përgjegjësit të Pastrim Gjelbërimit, janë emëruar punonjës me arsim të mesëm, kur vendi i punës kërkon punonjës me diplomë të integruar DIND, DND.

2.1. Rekomandim: Bashkia Konispol (në të cilën përfshihet Komuna Xarrë nga shkrirja e NJQV), të marrë masat e nevojshme, për rekrutimet e reja që do të kryejë në kuadrin e riorganizimit, për të përzgjedhur ato persona që përmbushin kriteret e nevojshme sipas pozicionit të punës dhe të kenë arsimin përkatës.

Vazhdimisht

3. Gjetje nga auditimi: Lidhur me organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit u konstatua se bilanci është mbajtur në mënyrë manuale dhe jo me IT, si dhe nuk është mbajtur ditari i veprimeve të ndryshme dhe Libri i Madh, duke mos pasqyruar veprimet që lidhen me dokumentimin e lëvizjen e aktiveve të qëndrueshme afatgjata të cilat pasqyrojnë gjendjen reale dhe të besueshme të pasurisë së institucionit, veprim në mos përputhje me ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3.1. Rekomandim:

Bashkia Konispol (në të cilën përfshihet Komuna Xarrë nga shkrirja e NJQV), të marrë masat e nevojshme për mbajtjen e kontabilitetit të saj, me një nga programet më të arrira që janë në

zbatim si “Alfa”, “Financa 5”, apo përsosjen e sistemit elektronik që mund të ketë në përdorim kjo Bashki.

Brenda muajit Tetor 2015

4.Gjetje nga auditimi: Komuna Xarrë, konstatohet se nuk i ka vlerësuar me vlerë reale, si dhe nuk ka bërë rivlerësimin e pasurive të paluajtshme të transferuara me çmimin e tregut sipas VKM nr. 378, datë 27.03.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyjeve dhe kullotave, që do të transferohen në pronësi të njësisë vendore”.

Këto pasuri nuk janë pasqyruar në aktivet e qëndrueshme të paraqitura në Pasqyrat Financiare të vitit 2013, 2014, veprim në kundërshtim me UMF. 30 datë “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe konkretisht:

Në llogarinë 210 (Tokë, troje, terrene), nuk janë paraqitur tokë, troje, terren të cilat janë transferuar sipas VKM nr. 110, datë 17.02.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, që do të transferohen në pronësi të njësisë vendore, komuna Xarrë të nën Prefekturës Sarandë”.

Në llogarinë 211(Pyje, Kullota, Plantacione), nuk janë paraqitur pyjet, kullotat dhe plantacionet, të cilat i janë transferuar komunës me VKM nr. 387, datë 27.03.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyjeve dhe kullotave, që do të transferohen në pronësi të njësisë vendore, komuna Xarrë të nën Prefekturës Sarandë.

Veprimet e mësipërme, vijnë në mospërputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”, VKM nr. 25 datë 20/01/2001, UMF nr. 26, datë 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor” dhe UMF. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

4.1. Rekomandim: Bashkia Konispol (në të cilën përfshihet Komuna Xarrë nga shkrimja e NJQV), të marrë masa për të bërë evidentimin e saktë dhe rivlerësimin e pasurive të paluajtshme dhe asetet që kanë qenë në administrim nga komuna Xarrë, duke i paraqitur në Pasqyrat Financiare të vitit 2015.

Brenda muajit Mars 2016

5. Gjetje nga auditimi: Komuna Xarrë në strukturën organike nuk ka patur magazinier dhe këtë detyrë, theksojmë se nuk e ka deleguar ndonjë personi tjetër në administratë. Nga ana e përdoruesve të mjeteve lëvizëse, nuk janë hartuar flet udhëtimet standarde ligjore, ku pasqyrohet urdhëruesi i lëvizjes, sasia e karburantit të tërhequr, km e përshkruara, llogaritja e harxhimit të karburantit sipas normativave teknike të automjetit për 100 km dhe sistemimi i diferencave në qoftë se ka.

Gjithashtu, janë dhënë karburant për përdoruesit e tjerë, kryesisht për mirmbajtje rrugë e pastrimin e kanaleve, por nuk janë hartuar preventiva për zërat e punimeve që do të kryhen në lidhje me pastrimin e kanaleve apo shërbimet e tjera të kryera, pa u plotësuar dokumentacioni dhe pa u zbatuar procedurat ligjore që autorizojnë dhe vërtetojnë kryerjen e shërbimeve.

Harxhimi i karburantit për vitin 2013, 2014 deri me 31.03.2015, pa dokumentacion të plotë ligjor, me vlerën 2,864,857 lekë përbën shkelje të disiplinës financiare, veprim në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

5.1. Rekomandim: Bashkia Konispol (në të cilën përfshihet Komuna Xarrë nga shkrimja e NJQV), të marrë masat e nevojshme, që për të gjitha punimet publike që kryen, të zbatojë procedurat ligjore për lëvizjen e vlerave materiale, duke zbatuar kërkesat ligjore në fuqi. Të marrë masa dhe të ketë në strukturën organike të saj magazinier (nëse nuk e ka vendosur deri tani), duke përcaktuar qartë detyrat funksionale të tij, në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Në kryerjen e prokurimeve, në 3 raste të përzgjedhjes së procedurës së prokurimit “me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës”, në vlerën 3,783,333 lekë, autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me nenin 33 “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit”, të LPP, dhe pikës 5, kreu IV, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, për arsye se, nuk kanë ekzistuar kushtet e përcaktuara në dispozitën për përdorimin e kësaj procedure. Rrethanat që kanë çuar në zgjedhjen e këtyre procedurave, janë subjektive e të

shkaktuara nga neglizhenca të autoritetit kontraktor (*Trajtuar më hollësisht në faqet 58-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandim: Bashkia Konispol (në të cilën përfshihet Komuna Xarrë nga shkrija e NJQV), të përdorë vetëm për raste të veçanta procedurën “Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, pasi me ndjekjen e zbatimit e kësaj procedure autoriteti kontraktor, në mungesë të konkurrencës, nuk arrin të realizojë plotësisht nevojat për mallra, punë e shërbime në sasi të njëjta me më pak burime, si dhe duhet të merren gjithashtu në konsideratë **ekonomiciteti, eficienta dhe efektiviteti** në zhvillimin e procedurave të prokurimit, si detyrë e njësisë së qeverisjes vendore.

Vazhdimisht

7. Gjetje nga auditimi: Në dosjen e tre tenderëve të kryer për blerje karburanti, mungon kërkesa zyrtare e argumentuar nga struktura përkatëse e komunës Xarrë, për nevojën e prokurimit, në kundërshtim me kërkesat e Urdhrit nr. 33, datë 11.07.2013 “*Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë*”, seksioni “Nxjerra e urdhrin të prokurimit/Kërkesa për prokurim dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”, i ndryshuar kreu I, pika 3/b.

- Nuk ka urdhër për ngritjen e grupit të punës për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për Rregullat e Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Kreu II pika 2/c.

- Fondi limit nuk është i argumentuar, pasi nuk ka relacion për mënyrën e llogaritjes së tij, të dhëna të sakta për sasinë e artikullit të prokuruar në përputhje me nevojat e komunës në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2010 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, kreu II, pika 2, germa “c” dhe “ç”*”.

- Në llogaritjen e çmimit të karburantit, nuk janë marrë parasysh të dhënat e botuara në buletin e APP-së, të marra nga bursa Reuters dhe nuk është bërë asnjë llogaritje se sa do të merret çmimi i karburantit për të llogaritur fondin limit. Pra për përcaktimin e çmimit të karburantit në momentin e hartimit të dokumenteve të tenderit, nuk është vepruar sipas kërkesave të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”, kreu III, pika 3, germa “b”.

- Në DST kriteret e veçanta të kualifikimit është përcaktuar kriteri që operatorët ekonomik “*Të kenë pika shitjeje afër akseve rrugore që ka në administrim Komuna Xarrë*”, veprim në kundërshtim me nenet 1 dhe 2 dhe 46 të LPP dhe Rregullat e PP, Kreu III dokumentet e tenderit.

Zgjedhja e procedurës së prokurimit me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës, është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” neni 33 “*Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit*” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, kreu IV, pika 5, pasi janë ndryshuar kushtet fillestare të kontratës.

-KVO-ja nuk ka përdorur të njëjtin standard në vlerësimin e kriterit të kualifikim-pranimit të operatorëve pjesëmarrës në procedurat e zhvilluara për periudhën 2013-2014 dhe Janar Maj 2015, kjo e ardhur dhe nga niveli i ulët teknik i punonjësve të ngarkuar për këto procedura. Konkretisht, ka s’kualifikuar për mangësi të konstatuara në dokumentacionin, ekonomik, financiar dhe teknik për plotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit operatorët ekonomik, por këto mangësi lehtësisht mund të konsideroheshin devijime të vogla, pasi nuk preknin dhe nuk ndikonin në ekzekutimin e kontratës;

-KVO-ja nuk ka hartuar raportin përmbledhës të zhvillimit të procedurave të prokurimit të miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor ose nga i autorizuari i tij, në kundërshtim me Kreu V pikën 4, të VKM nr.1, datë 10.01.2007, “*Për Rregullat e Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

7.1. Rekomandim: Bashkia Konispol (në të cilën përfshihet Komuna Xarrë nga shkrija e NJQV), duhet të forcojnë kontrollin e brendshëm në lidhje me procedurat e planifikimit dhe prokurimit që do të kryejnë në Bashki. Konkretisht:

Në parashikimin e nevojës për prokurime, kërkesës për prokurim dhe miratimi i saj, hartimin dhe miratimin e urdhrin për zgjedhjen e procedurës së prokurimi, ngritjen e komisionit të vlerësimit, fondit limit dhe specifikimeve teknike.

Vlerësimin dhe nënshkrimin e procesverbalit për llogaritjen dhe argumentimin e vlerësimit të kontratës si dhe hartimin dhe vlerësimin e specifikimeve teknike.

Në hartimin e projektit të zbatimit dhe preventivit; hartimin dhe miratimin e urdhrin të prokurimit; në përgatitjen, miratimin dhe hedhjen në sistem e dokumenteve të tenderit. Ngritjen

e komisionit dhe vlerësimit të ofertave; miratimin e raportit narrativ përmbledhës; njoftimin e ofertës fituese.

Vazhdimisht

8. Gjetje nga auditimi: Në mbështetje të Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 57 datë 11.6.2014, pika nr.3 në të cilën përcaktohet që: “*në referim të gjurmës standarde të auditimit, Titullari i çdo njësie publike të qeverisjes së përgjithshme (ku bën pjesë dhe qeverisja vendore), të hartojë gjurmën e detajuar të auditimit për njësitë që drejtojnë*”, duhet të ishte hartuar e miratuar gjurma e detajuar e auditimit, e cila do të përbëjë një bazë të hapave dhe procedurave që duhet të ndjekin të gjitha strukturat e bashkisë në këtë proces.

8.1. Rekomandim: Bashkia Konispol (në të cilën përfshihet Komuna Xarrë nga shkrirja e NJQV), të marrë masa për hartimin e gjurmëve të detajuara të auditimit për prokurimet publike dhe ta paraqesë për miratim te nëpunësi i autorizues.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në 3 raste në vlerën 79, 500 lekë në vitin 2013 dhe në 5 raste në vlerën 799,055 lekë në vitin 2014, autoriteti kontraktor, nuk ka zbatuar pikën 5, të nenit 29 të të LPP, ku shprehimisht përcaktohet se: “Procedurat standarde të prokurimit”. Për prokurimet me vlerë të vogël, nën kufirin e ulët monetar, të mallrave, shërbimeve apo punëve, autoritetet kontraktore mund të përdorin procedura të thjeshtuara, të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik, pika 2, e kreut VI, të RRPP dhe Udhëzimeve të APP, të ndryshuar, për arsye se nuk ka zbatuar procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.

-Likuidim me vonesë i praktikës bashkëlidhur, në kundërshtim me udhëzimin e KM nr.2 datë 06. 02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

9.1. Rekomandim: Bashkia Konispol (në të cilën përfshihet Komuna Xarrë nga shkrirja e NJQV) të marrë masa që për të gjitha prokurimet me vlerë të vogël, të përdoren procedurat e thjeshtuara dhe të kryhen pagesat në kohë e mos të rëndohet situata financiare, duke shtuar kreditorë të palikujduar.

Vazhdimisht

10. Gjetje nga auditimi: - Në Komunën Xarrë, gjendja e llogarive të detyrimeve debitoare në bilancet e vitit 2013, 2014 dhe progresivisht, deri në fund të 5 mujorit e vitit 2015, për biznesin të vogël, taksën e tokës bujqësore, taksën e pasurisë dhe tarifën e pastrimit, rezultojnë në shumën **11,121,200 lekë**.

10.1. Rekomandim: Bashkia Konispol (në të cilën përfshihet Komuna Xarrë nga shkrirja e NJQV) dhe Sektori i Taksave Vendore, të marrin masa të nevojshme, duke sensibilizuar banorët e ish komunës Xarrë, për arkëtimin e detyrimeve për: biznesin e vogël, taksën e tokës bujqësore, taksën e pasurisë dhe tarifën e pastrimit në vlerën **11,121,200 lekë**, si detyrime të papaguara nga viti 2013 deri në 5 mujorin e vitit 2015.

Brenda muajit Mars 2016

11. Gjetje nga auditimi: Në juridiksionin e komunës Xarrë, ka qenë zëri “toka bujqësore të pandara, pronë e Ministrisë së Bujqësisë sipas ligjit 8312, datë 26.03.1998, sipërfaqja prej 217,4 ha, e cila është dhënë me qira në përputhje me Udhëzimin nr. 3 datë 16.05.2007 “ Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”.

Në auditimin e procedurave për dhënie me qira të tokës bujqësore rezultojnë se, nuk disponohen të dhënat mbi datën e lidhjes së kontratave me fituesit e lartpërmendur të ankandit, si dhe deri në periudhën e auditimit nuk ka korrespondencë shkresore me Ministrinë e Bujqësisë për arkëtimin e qirasë. Nga tabela e mësipërme qiraja ka filluar që nga viti 2000, ndërsa llogaritjet që paraqesim i përkasin periudhave të vitit 2013, 2014 dhe 5 mujorin e vitit 2015 dhe rezultojnë me një efekt financiarë në të ardhurat e komunës për **shumën 6,196,224 lekë**, ardhur kjo nga mos zbatimi i tarifave të caktuara.

11.1. Rekomandim: Bashkia Konispol (në të cilën përfshihet Komuna Xarrë nga shkrirja e NJQV), Inspektorati Mbrojtjes së Territorit dhe ZAMT, të marrin masa duke evidentuar me grup pune dhe kërkuar zyrtarisht të dhëna nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, gjendjen aktuale të përfituesve të ankandëve, për marrjen me qira të tokës nga fondi i kësaj Ministrie, si dhe të merren masa për arkëtimin e shumës **6,196,224 lekë**. Njëkohësisht, mbështetur në këto të dhëna, të llogariten detyrimet e plota të qirasë për subjektet përfituese (nga ankandet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit), si dhe të rakordojnë për kalimin e të ardhurave në buxhetin e ardhshëm, duke marrë masa për arkëtimin e tyre.

Brenda muajit Nëntor 2015

12. Gjetje nga auditimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk u ka kërkuar subjekteve debitore vendosjen e barrës sigurorese (në Drejtorinë Rajonale të Transportit Sarandë për mjetet), apo Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, kjo bazuar nën 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore".

12.1. Rekomandim: Bashkia Konispol (në të cilën përfshihet Komuna Xarrë nga shkrija e NJQV), Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për rastet e subjekteve, të cilët nuk paguajnë detyrimet, të vendosi masë sigurie mbi të gjithë pasurinë e tatim paguesit.

Vazhdimisht

13. Gjetje nga auditimi: Komuna Xarrë, i ka kërkuar delegimin e i kompetencave Këshillit të Qarkut Vlorë për administrimin e territorit të kësaj komune "Delegimin e funksionit të planifikimit urban dhe dhënies së lejeve zhvillimore të ndërtimit nga Komuna Xarrë", bazuar në kërkesat e nenit 8, paragrafit V, nenit 12, pika 7, nenit 13, pika 2, të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar.

Komuna nuk ka miratuar planin e zhvillimit të territorit sipas kërkesave të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit". Për periudhën e audituar nuk janë dhënë leje ndërtimi

- Procesi i inventarizimit të pronës publike dhe transferimi në komunën Xarrë nuk ka kaluar në fazat si më poshtë:

-Në fazën e parë, Komuna Xarrë nuk ka miratuar në Këshillin e Ministrave listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bazuar në inventarin e miratuar nga këshilli vendor me vendim nr. 16, datë, 15.05.2008.

-Në fazën e dytë, nuk ka miratuar në Këshillin i Ministrave listën paraprake të pjesshme apo tërësore paraprake, të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat rekomandohen për transferim në pronësi dhe në përdorim të komunës, së bashku me kushtet dhe kufizimet e pronave të formuluar nga Këshilli i Ministrave, në bazë të listës së inventarizimit dhe të kërkesës së komunës.

-Në fazën e tretë, nuk ka miratuar në Këshillin e Ministrave listën përfundimtare të pjesshme ose tërësore të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat transferohen në pronësi dhe në përdorim të komunës sipas propozimeve të këshillit vendor, pas shqyrtimit nga Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronës Publike(AITPP) të vërejtjeve që kanë për pronat e miratuara në listat paraprake dhe bazuar në informacionin përfundimtar, përfshi dhe kushtet apo kufizimet që u vihen, përkatësisht, për secilën pronë.

Pas miratimit të listës së pronave të transferuara dhe regjistrimit të këtyre pronave në emër të komunës, kjo e fundit, si edhe pronari i mëparshëm, duhet të reflektojnë çdo pronë, si aset, në bilancet e veta, sipas ligjit "Për kontabilitetin".

- Komuna Xarrë nuk ka regjistruar në ZVRPP pronat me arsyetimin për pamundësinë financiare të tarifave të regjistrimit dhe mospërputhjen e hartave, sidomos me sipërfaqeve pyjore. Mos inventarizimi i pronave troje, tokë bujqësore, sheshe, rrugë, etj, ka ardhur nga mospërputhja e përmasave të pronave të komunës dhe ZVRPP, si dhe konfliktet midis njësive të qeverisjes vendore, për kufirin ndarës midis tyre, të cilat kanë bllokuar procedurat e inventarizimit dhe transferimit.

13.1. Rekomandim: Bashkia Konispol (në të cilën përfshihet Komuna Xarrë nga shkrija e NJQV), të hartoj program pune për miratimin në KM të listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bazuar në inventarin e miratuar nga këshilli vendor i ish komunës Xarrë me vendim nr. 16, datë, 15.05.2008, të listës paraprake të pjesshme apo tërësore paraprake, të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat rekomandohen për transferim në pronësi dhe në përdorim të komunës. Këto regjistrime do të bëhen për listën përfundimtare të pjesshme ose tërësore të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat transferohen në pronësi dhe në përdorim të ish komunës Xarrë sipas propozimeve të këshillit vendor, pas shqyrtimit nga Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronës Publike(AITPP).

Brenda muajit Dhjetor 2015

14. Gjetje nga auditimi: Komuna Xarrë, nuk ka identifikuar inventarin e pronave të tipit pyje dhe kullota brenda territorit të saj administrativ.

-Nuk ka plotësuar dokumentacionin tekniko ligjor bazuar në shkresat e MMPAU me nr. 4086, datë 31.07.2011 "Për përhaptimin e procedurave të transferimit të pyjeve në varësi të komunave" dhe nr. 3868, datë 03.05.2012 "Mbi procedurat e verifikimit kadastral dhe transferimit të pyjeve e kullotave në NJQV", ku janë përcaktuar hapat që duhen ndjekur për realizimin e këtij procesi.

-Komuna Xarrë, nuk ka hartuar plan menaxhimi e mbarështimi në pyje kullota livadhe, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve drusore, kullosore, produkteve dytësore si bimësi të ndryshme, vjeljen e gjahut dhe të shërbimeve çlodhëse etj, për krijimin e të ardhurave dytësore të cilat do të siguronin zhvillim të qëndrueshëm, burime të ardhurash dhe vënien në efikasitet të plotë të këtyre resurseve për periudhën 2013 – 6/mujori 2015, veprim në kundërshtim me Vendimin e KM nr. 22, datë 9.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të Kriterëve të Administrimit të Pyllit Komunal”, pikat 3, 4 e në vijim. Për periudhën 2013-2014 është bërë i mundur realizimi i të ardhurave nga përdorimi i fondit pyjor (kullota), për vitin 2013 në shumën 462,000 lekë, për vitin 2014 në shumën 441,000 lekë, gjithsej për gjithë periudhën në **shumën 903,000 lekë**.

14.1. Rekomandim: Bashkia Konispol (në të cilën përfshihet Komuna Xarrë nga shkrirja e NJQV), të marrë masa për inventarizimin e pyjeve dhe kullotave dhe transferimin e tyre në pronësi ose në përdorim të ish njësisë vendore Xarrë, hartimin e planit të menaxhimit dhe mbarështimit në pyje, kullota, livadhe, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimësi të ndryshme, vjeljen e gjahut dhe të shërbimeve çlodhëse, dhënien me qira të pronave të veta etj, si dhe krijimin e të ardhurave dytësore të cilat do të siguronin zhvillim të qëndrueshëm, burime të ardhurash dhe vënien në efikasitet të plotë të këtyre resurseve.

Brenda muajit Dhjetor 2015

15. Gjetje nga auditimi: Për të gjitha kontratat (28) të dhënies me qira të fondit kullosor, konstatohet se, nuk ka ekstrakt nga QKR për objektin e veprimtarisë, si dhe dokument identifikimi të kërkuarit apo kërkuarëve, ose vërtetimi nga komuna/bashkia për vendbanimin dhe numrin e bagëtive që kërkuarët ka të regjistruar në pronësi, siç përcaktohet në pikën 5, të udhëzimit nr. 4, datë 10/04/2008 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari.

-Për çdo kontratë nuk administrohet dokument shkresor, lidhur me miratimin nga këshilli i komunës të dhënies me qira të sipërfaqes dhe konfirmimi nga Prefekti..

-Pronat të cilat janë dhënë me qira, nuk figurojnë të regjistruar në ZVRPP Sarandë, pasi nuk është bërë kalimi i saj në pronësi apo përdorim të komunës Xarrë.

15.1. Rekomandim: Bashkia Konispol (në të cilën përfshihet Komuna Xarrë nga shkrirja e NJQV), të hartojë një program pune dhe të rivlerësojë dhe të rihartojë kontratat e dhënies me qira të sipërfaqeve kullosore, konform dispozitave ligjore të cituar në gjetjet e mësipërme, duke zbatuar tarifën e përcaktuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.2. Rekomandim: Nëpunësit autorizues dhe zbatues të marrin masa, që pas përfundimit të procesit të inventarizimit, transferimit dhe regjistrimit të venë në efikasitet këto prona, duke shfrytëzuar kapacitetet pyjore e kullosore.

Vazhdimisht

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, nga Bashkia Konispol (në të cilën përfshihet Komuna Xarrë nga shkrirja e NJQV), të nxirren aktet administrative dhe të kërkohet shpërblimi i dëmit **në vlerën 2,742,646 lekë** si me poshtë:

1. Gjetje nga auditimi. Shpërblimi i anëtarëve të këshillit të komunës është bërë në zbatim të pikës 16 të VKM nr. 1619, datë 2.7.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar. Në listë pagesat mbi shpërblimin e këshilltarëve është llogaritur dhe ndaluar tatimi mbi të ardhurat duke e derdhur çdo muaj në llogarinë e Drejtorisë Rajonale të Tatimit Taksave Sarandë.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se anëtarët e këshillit të komunës janë paguar edhe për ditë që nuk kanë marrë pjesë në mbledhje. Në total kjo pagesë është në shumën **2,451,600 lekë**, e cila përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e komunës .

1.1.Rekomandimi: Bashkia Konispol (në të cilën përfshihet Komuna Xarrë nga shkrirja e NJQV), të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e pagesave të marrë padrejtësisht nga anëtarët e këshillit të ish komunës Xarrë, të bëjnë arkëtimin e shumës **2,451,600 lekë**.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi përcaktimin e pagave sipas klasifikimit të funksioneve dhe vendeve të punës në shërbimin civil dhe atyre me kod pune për vitin 2013, 2014 deri me 31.05.2015, rezultoi se në komunën Xarrë, nuk janë zbatuar kriteret e VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar dhe konkretisht:

-Sekretari i Këshillit të Komunës është paguar me pagë 35,190 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të njësive të qeverisjes vendore”,

- Punonjësi i Policisë së Komunës është paguar me pagë 38,500 lekë dhe 40,000 lekë në muaj, në kundërshtim me VKM nr. 1619, datë 02.07.2008, **ose 169,500 lekë**, e cila përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik të arkëtueshëm nga z. A.R.

2.1.Rekomandim: Bashkia Konispol (në të cilën përfshihet Komuna Xarrë nga shkrirja e NJQV), të marrë masa për arkëtimin e vlerës **191,970 lekë**, përkatësisht nga z. **A.R në vlerën 169,500 lekë dhe znj. D.A në vlerën 22,470 lekë**, paguar më tepër se sa përcaktuar në pikat 18, 19, 20/6 të VKM nr. 1619, datë 02.7.2008, i ndryshuar.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në transaksioni nr. 164, datë 12.11.2014, në vlerën 99,076 lekë me objekt shpenzimi “Garanci punimesh”, likuiduar operatorin ekonomik “J...”, u konstatua se: *Likuidimi i garancisë së punimeve është kryer para afatit të garancisë së objektit.*

3.1.Rekomandim: Bashkia Konispol (në të cilën përfshihet Komuna Xarrë nga shkrirja e NJQV), të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **99,076 lekë**, nga operatori ekonomik “J...”, për likuidimin para afatit ligjor të përcaktuar në kontratë, të garancisë së punimeve.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në germa “e” dhe “ç”, neni 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale tip, i kemi rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Konispol (ku është përfshirë ish komuna Xarë), fillimin e procedurave administrative për dhënien e masës disiplinore, nga “**Vërejtje**” deri në “**Ndërprerje të marrëdhënie të punës**”, sipas shkallës së përgjegjësisë, për këta punonjës:

1. **z. F.K.**, me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Bujqësisë;

2. **znj. V.T.**, me detyrë Përgjegjëse e Zyrës Veterinare;

Për arsye se:

Në dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore për kullota, është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, neni 15 “Përdorimi për kullotje”, neni 17 “Përdorimi i sipërfaqes dhe i tokës”, neni 18 “Miratimi i veprimtarive në fondin kullosor”, neni 29 “Organet e kontrollit”, neni 30 “Dokumentimi”, neni 33 “Vlerësimi i dëmit”, si dhe neni 34 “Kundravajtjes Administrative”, ku shkelja e këtyre dispozitave ka të bëjë me mos ndjekjen e procedurave të konkurrencës, mos mbajtjen e akteve të kontrollit, mos përcaktimin në kontratë të kontureve të sipërfaqes, si dhe mos evidentimit të përdorimit apo jo të së njëjtës sipërfaqe të dhënë me qira apo përdorimit edhe të sipërfaqeve të tjera, si dhe ligjit nr. 10 120, datë 23.04.2009 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”. Po ashtu rezulton se nuk është zbatuar as VKM nr. 1, datë 02.7.2012 “Për përcaktimin e kriterëve të konkurrencës dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor e kullosor publik”.

D. MASA ADMINISTRATIVE

Nga auditimi i ushtruar në Komunën Xarrë, u konstatuan mangësi dhe shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”.

Bazuar në germën “ç” të nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, date 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” neni 7, pika 2, 3/a, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, që në

zbatim të nenit 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu X, të shqyrtojë dhe të marrë masa disiplinore ndaj anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Njesisë së Prokurimit, **konkretisht:**

1. **Zj.A.P**, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
2. **Zj. H.S**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
3. **Z. S.D**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për arsye se:

Nuk është hartuar raporti përmbledhës, vendimi i titullarit të autoritetit kontraktor në lidhje anulimin e procedurës, në të tre tenderat e zhvilluar me objekt “Blerje karburanti”, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu V “Zhvillimi i procedurave”, pika 1 germa “c”, pika 2 germa “a” dhe “c”. Autoriteti kontraktor nuk ka publikuar në BNJP anulimi i procedurës kërkesë për propozim zhvilluar më datë 20.03.2013, në kundërshtim me LPP dhe rregullat e P.P.

4. **z. V.L** në cilësinë e Juristit të Njesisë së Prokurimit;
5. **z. A.LLj**, në cilësinë e Specialistit të Njesisë së Prokurimit;
6. **z. E.P**, në cilësinë e Specialistit të Njesisë së Prokurimit.

Për arsye se:

Në 3 (tre) raste në vlerën 3,783,333 lekë, zgjedhja e procedurës së prokurimit me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës, është bërë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” neni 33 “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IV, pika 5, **pasi janë ndryshuar kushtet fillestare të kontratës**. Referuar VKM-së së mësipërme kreu IV, pika 5 thuhet se procedura me negociim, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës, mund të përdoret:

- Nuk ka urdhër për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu II pika 2/c.
- Fondi limit nuk është i argumentuar pasi nuk ka relacion për mënyrën e llogaritjes së tij, të dhëna të sakta për sasinë e artikullit të prokuruar në përputhje me nevojat e komunës në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2010 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, kreu II, pika 2, germa “c” dhe “ç”.
- Në llogaritjen e çmimit të karburantit nuk janë marrë parasysht të dhënat e botuara në buletin e APP-së, të marra nga bursa Reuters dhe nuk është bërë asnjë llogaritje se sa do të merret çmimi i karburantit për të llogaritur fondin limit. Pra për përcaktimin e çmimit të karburantit në momentin e hartimit të dokumenteve të tenderit, nuk është vepruar sipas kërkesave të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, kreu III, pika 3, germa “b”.
- Kriteret e përdorura për vlerësimin e ofertave nuk janë specifikuar në mënyrë të saktë nga ana e autoritetit kontraktor, për rrjedhojë lejojnë Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, t’i interpretojnë ato në mënyra të ndryshme në procedurë të ndryshme madje me impakt financiar në dëm të autoritetit kontraktor.

Nga Bashkia Konispol, ka kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Xhovan Domi Genc Koka, Shefki Jaupi dhe Jonild Hoxhaj, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

